



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	
Dep.	
Nr. f. faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-1962/15
Br. Prot.	
Prot No	
Data	
Datum	15.07.2015
Date	
PUNA SHTETËSE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK- 03-02-393/15, për z. Blerim Çeku – Udhëheqës i Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), të dyshuar për konflikt interes i lidhur me tenderin: “Ofrimi i shërbimeve inxhinierike për projektin dhe mbikëqyrje të projekteve”, me numër të prokurimit 210 14 035 211, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interes për z. Blerim Çeku, nr. AKK – 03-02-393/15, lidhur me tenderin: “Ofrimi i shërbimeve inxhinierike për projektin dhe mbikëqyrje të projekteve”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje Ligji PKI).

Pas pranimit të informacionit nga Gazeta “Zëri” dhe kërkesës së zyrtarit Çeku, për të sqaruar situatën e konfliktit të mundshëm të interesit në rastin e dhënes së këtij tenderi, Agjencia kundër Korrupsionit ka ftuar në takim z. Çeku si dhe ka kërkuar dosjen e tenderit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Dyshimet për konflikt interes kanë qenë sepse, sipas denoncuesit të rastit, z. Çeku, përmes kompanisë “Northwest”, bashkëpunon në projekte të ndryshme me kompaninë AlbArchitects e cila tash është fituese e këtij tenderi.

Në bazë të dhënave të dosjes së tenderit, të siguruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia ka konfirmuar se kompania fituese e këtij tenderi është “AlbArchitects”, ndërsa për dhënien e tenderit është formuar komision i veçantë, ashtu siç parashihet me Ligjin për Prokurimin Publik.

Po ashtu, nga dosja e tenderit kemi konfirmuar se z. Çeku nuk ka marrë pjesë në asnje procedurë të dhënies së këtij tenderi dhe rrjedhimisht nuk ka pasur kompetencë në dhënien e vendimit për tenderuesin e suksesshëm.

Fakti që z. Çeku ka bashkëpunuar në të kaluaren me kompaninë fituese të tenderit, përmes kompanisë “Northwest”, nuk ia mohon të drejtën kësaj kompanie për të marrë tender në këtë institucion. Kjo për arsy se Ligji PKI nuk e ka paraparë një kufizim të tillë.

Ky ligj, në nenin 15, ka paraparë kufizimet “absolute” vetëm për zyrtarët të cilët lidhin kontrata me ato institucionë të cilat kanë pozita vendimmarrëse:

“Ndërmarrja ne të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë te lidhi kontratë ose te përfitoj ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse”.

Në këtë rast z. Çeku është në pozitë vendimmarrëse në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mirëpo nuk është pronar i kompanisë fituese.

Po ashtu lidhja e kësaj kontrate nuk paraqet as kufizim të natyres relative (konflikt “rast për rast”), sepse z. Çeku nuk ka marrë pjesë nëasnje procedurë në dhënien e këtij tenderi.

Situatë e konfliktit “rast për rast” mund të paraqitet gjatë menaxhimit të kësaj kontrate, në rast se z. Çeku merrë pjesë në vlerësimin e përbushjes së kësaj kontrate. Për këtë arsy, në takimin që kemi pasur me z. Çeku, i është bërë me dije se nuk i lejohet të marrë pjesë në procedurat e menaxhimit të kësaj kontrate.

Në pajtim me këto dispozita, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

